UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI
Nr. i arkivit dt. 30.10.2026
Nr. i klasifikimit | Numri 2664 | Nr. Ekzem. | Vlera

UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti Juridik

Kryesues i Këshillit
Prof. Dr. Islam Qerimi

Nr. Prot. 390 Dt. 30.10.2026

KËSHILLI I FAKULTETIT JURIDIK, në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, Këshilli i Fakultetit Juridik, në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2026, nxjerr këtë:

K O N S T A T I M

I. Konstatohet se janë kryer veprimet lidhur me Raportin nr. prot. 382, dt. 28.10.2026, të Komisionit Vlerësues për pozitën e shpallur në Konkursin për zgjedhjen, rizgjedhjen apo avancimin e personelit akademik në UIBM, të shpallur më datë 23.09.2026, si dhe korrigjimin e konkursit të datës 29.09.2026.

Raporti i Komisionit Vlerësues lidhur me pozitën për lëndët për të cilat është shpallur konkursi "Taktikat Kriminalistike", "Kriminologji dhe Penologji", "Viktimologjia"," Bazat e Sistemit të Drejtësisë", "Terrorizmi dhe Antiterrorizmi" dhe "Politika e Luftimit të Kriminalitetit" është i kompletuar në përputhje me kriteret e përcaktuara me Rregulloren nr. 3013/1, dt. 21.12.2023, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM, dhe Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për procesin zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avncimit të personelit akademik në UIBM, me nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024, dhe, si i tillë, brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore, i përcillet Zyrës për Çështje Akademike të Universitetit për publikim në Buletin.

Bashkëngjitur këtij konstatimi gjeni:

Raportin e Komisionit Vlerësues për pozitën "Taktikat Kriminalistike", "Kriminologji dhe Penologji", "Viktimologjia", "Bazat e Sistemit të Drejtësisë", "Terrorizmi dhe Antiterrorizmi" dhe "Politika e Luftimit të Kriminalitetit".

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit

Prof. Dr. Islam Qerimi

I dërgohet:
Zyrës për çështje akademike të UIBM-it,
Dekanit të FJ,
Sekretarit të FJ,
Arkivit të Fakultetit.

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

Raporti i Komisionit vlerësues për rizgjedhjen dhe avancimin të personelit akademik sipas konkursit me Nr. Prot: 2193, datë 23.09.2026 si dhe korigjimin e konkurësit për këtë pozit me Nr. Prot: 2249, datë: 29.09.2026.

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI
Pranuar me dt 30.10.2026
Njësia orga | Num | Nr.Ekzem | Vlera
| 26641/1 |

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI JURIDIK
Pranuar me dt. 28.10.2026
Njësia organ. | Numër | Nr.Ekzempl. | Vlera
| 382 |

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES

Fakulteti:	Juridik
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi:	1.Taktika kriminalistike. 2. Kriminologji me Penologji. 3. Viktimologjia. 4. Bazat e sistemit të drejtësisë. 5. Terrorizmi dhe Antiterrorizmi. 6. Politika e luftimit të kriminalitetit.
Kandidatët e paraqitur:	1. Agron Beka

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar/e	Prof. Asoc. Dr. Besnik Murati
2. Anëtar/e	Prof. Dr. Arsim Bajrami
3. Anëtar/e	Prof. Dr. Rexhep Gashi

Shënimet për kandidatin/en për të cilin/ën shkruhet raporti
Kandidati/ja 1

Emri dhe mbiemri	Agron Beka
Datëlindja dhe vendlindja	14.01.1967 – Vushtrri
Grada shkencore	Doktor i Shkencave Juridike
Titulli akademik	Profesor i Asociuar - Prof. Asoc. Dr.
Viti kur është fituar titulli aktual	2020
Universiteti/Fakulteti	Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë, Fakulteti Juridik
Departamenti/Programi	Juridik

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit/es

Tabela I: Punimet e publikuara pas thirrjes së fundit në revista, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike, sipas Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024 dhe me Vendimin e Senatit me nr.prot.1757 dt.06.08.2024.

Nr	**Autori/ët**	**Titulli i punimit**	**Platforma**	**Revista**	**Impa Faktori**	**Viti vëllimi, nr., faqet**	**Linku identifikues[1]**
1	1. Agron Beka 2. Agon Beka	Trafficking of Human Beings and the Causes of This Trafficking in Kosovo	SCOPUS	Access to Justice in Eastern Europe Case Study	1.7	Viti 2025, Vellimi 8 (3), fq. 558-572	https://ajee-journal.com/trafficking-of-human-beings-and-the-causes-of-this-trafficking-in-kosovo https://doi.org/10.33327/AJEE-18-8.3-c000112
2	1. Agron Beka 2. Alketa Marku 3. Shukrije Rama	The Influence of Social Groups and Educational Institutions on the Formation	SCOPUS	Journal of Educational and Social Research	1.5	Viti 2026, Vol 16 No 4, Fq. 290-303	https://www.richtmann.org/journal/index.php/jesr/article/view/14819

[1] Komisioni vlerësues është i obligjuar të shënojnë linkun nëpërmjet të të cilit dëshmohet indeksimi i punimit përkatësisht revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse

		Of Deviant Behaviour					https://doi.org/10.36941/jesr-2026-0370
3	1. Agron Beka 2. Valeza Kastrati	Organized Crime in the Field of Real Estate and its Connection to Money Laundering: A Perspective from Kosovo	SCOPUS	Interdisciplinary Journal of Research and Development	0.5	Viti 2026, Vol 13, No 2, Fq. 556-564	https://www.journal-uamd.org/index.php/IJRD/article/view/837 https://doi.org/10.56345/ijrdv13n244

Sqarim: Autor i parë konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve. Autori korrespodent konsiderohet autori i punimit, i cili shprehimisht është përcaktuar si i tillë në punim. Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë se 1 (një) autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë. Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.

Në tabelë duhet të prezantohen punimet pas thirrjes së fundit. Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UIBM -së dhe Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024. Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave për punimet e radhitura në këtë tabelë.

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën I.

(Komisioni vlerësues duhet të ofrojë informata për tipin e publikimeve, për revistën në të cilën ka botuar autori duke iu referuar statusit të kandidatit/es në kuadër të punimit (p.sh. autor i parë etj), "impakt faktorin" e revistës, shtëpinë botuese, ORCID ID etj. Komisioni duhet të precizojë burimin e informatave në të cilin është mbështetur dhe i cili mund të verifikohet. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

1. Punimi me titull: "Trafficking of Human Beings and the Causes of This Trafficking in Kosovo" është publikuar në revistën shkencore ndërkombëtare Access to Justice in Eastern Europe, e indeksuar në SCOPUS me impact factor 1.7. Kandidati Agron Beka është autor i parë i këtij punimi (bashkëautor Agon Beka) dhe autor korrespondent sipas faqes së punimit. Shtëpia botuese është East European Law Research Center, me ORCID ID https://orcid.org/0009-0003-6047-0522 .

2. Punimi me titull: "The Influence of Social Groups and Educational Institutions on the Formation of Deviant Behaviour" është publikuar në revistën shkencore ndërkombëtare Journal of Educational and Social Research, e indeksuar në SCOPUS me impact factor 1.5. Kandidati Agron Beka është autor i parë i këtij punimi (bashkëautorë Alketa Marku dhe Shukrije Rama). Shtëpia botuese është Richtmann Publishing Ltd, me ORCID ID https://orcid.org/0009-0003-6047-0522 .

3. Punimi me titull: "Organized Crime in the Field of Real Estate and its Connection to Money Laundering: A Perspective from Kosovo" është publikuar në revistën shkencore ndërkombëtare Interdisciplinary Journal of Research and Development, e indeksuar në SCOPUS me impact factor

0.5. Kandidati Agron Beka është autor i parë i këtij punimi (bashkëautore Valëza Kastrati). Shtëpia botuese është UAMD University (Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës), me ORCID ID https://orcid.org/0009-0003-6047-0522 .

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

(Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit/es, universitetet ku ai/ajo ka punuar, programet akademike, kualifikimet, angazhimi në institucione jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e *paraqitura, duhet të bashkëngjiten në këtë raport).*

Kandidati Agron Beka ka përfunduar studimet themelore (Jurist) dhe magjistraturën (Mr.Sc., Penal) në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa në vitin 2013 ka përfunduar doktoraturën në fushën e shkencave penale - kriminologjike) në Fakultetin Juridik "Justiniani I" të Universitetit të Shkupit "Kiril dhe Metodi"dhe ka marr titullin: Doktor i Shkencave Juridike (Dr.Sc.)

Kandidati ka qenë mësimdhënës në disa institucione të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës: ligjërues në Kolegjin Dardania (2007-2010) dhe në Kolegjin e Biznesit (2007-2009); profesor në Kolegjin Evropian Juridica (2011-shtator 2019) me seli në Prishtinë, ku ka qenë edhe dekan (2012-2015); dhe nga viti 2015 është në Fakultetin Juridik të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, ku është aktualisht në thirrjen akademike Profesor i Asociuar (titulli aktual i fituar në vitin 2020). Në vitin 2017 - 2019 ka qenë U.D.Dekan i Fakultetit Juridik- UMIB dhe nga 2019 – 2022 ka qenë Dekan. Poashtu gjatë periudhave të ndryshme të cekura ka qenë: Senator, anëtar i Komisionit të Studimeve; Kryesues i Këshillit të Fakultetit Juridik, etj.

Në periudhën 2007-2019 ka qenë mentor, kryetar dhe anëtar i komisionit të mbi 100 studentëve me rastin e diplomimit në studimet Bachelor dhe Master. Ka kryer certifikimin në Pedagogjinë e Mësimdhënies (Ohio Northern University, SHBA, dhe UIBM); Certifikata e Universitetit të Hong Kongut - Universiteti i Hong Kongut, 2023, kursi: Mësimdhënia Universitare; Certifikata e Universitetit Coventry, kursi: Eksplorimi i Mësimdhënies dhe Vlerësimit në Arsimin e Lartë, 2023.

Kandidati ka botuar libra si "Taktika Kriminalistike" (2017, bashkëautorësi), "Vrasjet, Krimi i Organizuar, Terrorizmi - Zbulimi dhe të Provuarit" (2013, bashkëautorësi), "Bazat e sistemit të drejtësisë" (ligjërata të autorizuara, 2026),"Viktimologjia" (cikël leksionesh,elekt., 2022) si dhe "Krimi i Organizuar në Urbanizëm dhe Qarkullim të Pasurive të Paluajtshme" (temë doktorate, monografi, 2015); "Abuzimet në lëmin e qarkullimit të pronës së paluajtshme në Kosovë" (2007); "Noteria dhe Kadastri" (2009), si dhe ka publikuar 16 punime shkencore gjatë periudhës 2021 - 2026 në revista shkencore ndërkombëtare.

Tabela II. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave dhe dispensave,

Nr	Autori/ët	Titulli i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti	Numri ISBN
1	Agron Beka	Bazat e sistemit të drejtësisë (ligjërata të autorizuara)	2026	

2	Agron Beka	Viktimologjia (cikël leksionesh, elektronik)	2022	
3	Vesel Latifi - Agron Beka	"Taktika Kriminalistike" (Libër)	2017	
4	Agron Beka	"Krimi i Oranizuar në Urbanizëm dhe Qarkullim të Pasurive të Paluajtshme" (Libër- Monografi)	2015	
5	Agron Beka	"Vrasjet, Krimi i Organizuar, Terrorizmi - Zbulimi dhe të Provuarit" (Libër)	2013	
6	Agron Beka	"Noteria dhe Kadastri" (Libër)	2009	
7	Agron Beka	"Abuzimet në lëmin e paluajtshmërive në Kosovë" (Libër)	2007	

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave të radhitura në tabelën III.

Tabela III. Publikimet nga kongreset dhe konferencat në nivel ndërkombëtar dhe vendor

Nr	**Autori/ët**	**Titulli i punimit**	**Emërtimi i kongresit, konferenca,**	**Vëllimi, nr., faqet, viti (të dëshmuara me proceedings book, botimi i përmbledhjes së abstrakteve ose agjenda)**
1	Agron Beka	Korrupsioni dhe krimi i organizuar si aktivitete kriminale dhe pengesa serioze për avancimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.	University "Kadri Zeka" Gilan-Republic of Kosovo Gender Equality UKZ Annual Conference, Scientific Identity and Creativity in a Changed World, Gilan, 2022.	2022
2	Agron Beka	Disa forma të krimit të organizuar dhe korrupsionit në	Konferenca Shkencore "Të drejtat e njeriut, kriminaliteti dhe ekonomia në	2021

		periudhën e pandemisë COVID-19	kohë të pandemisë COVID-19", Fakulteti Juridik – UIBM (kryesues i Këshillit Organizativ)	
3	Agron Beka Agon Beka	"Korrupsioni dhe krimi i organizuar si një sfidë për tranzicionin e Kosovës"	"The state, society and law: challenges and conditions to peace, democracy, development and integration", organizuar nga Fakulteti i Shkencave Politike dhe Drejtësisë - Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrrës, Shqiperi	2025
4	Agron Beka Agon Beka	The consenquences of organized crime in the field of urbanism and real estate circulation	International Congress on Human, Social Sciences and Arts, University of Tetova, Republic of North Macedonia.	2023
5	Agron Beka Agon Beka	Some of the abuses in kosovar sport - preventing and combating them	International Congres on Natural, Health Sciences and Technology – University of Tetova International Balkan Conference in Sport Sciences, Tetova, North Macedonia	2025
6	Agron Beka Agon Beka	The justice system and the challenges faced by lawyers in Kosovo	International Congress on Human, Social Sciences and Arts, University of Tetova, Tetova, North Macedonia, 2024	2024
7	Agron Beka Agon Beka	Some of the forms of corruption according to	International Congres on Human, Social Sciences and Arts,	2022

		the criminal code of Republic of Kosovo	University of Tetova, Tetova, North Macedonia	

Tabela IV. Pjesëmarrja në Komitetet shkencore në kongreset dhe konferencat në nivel ndërkombëtar dhe vendor

Nr	Emërtimi i kongresit, konferencës	Linku /libri i publikimeve
1	/	/

Tabela V. Pjesëmarrja në komisionet vlerësuese për zgjedhje dhe avancim të stafit akademik

Nr	Pozitat e konkursit	Pozita në komision	Viti
1	/	/	/

Tabela VI. Mentorimi i temave të diplomës

Nr	Emri Mbiemri (i kandidatit/es)	Niveli i studimit	Viti i përfundimit
1	/	/	/

Sqarim: Plotësohet tabela me emrat e kandidatëve pas thirrjes së fundit.

Tabela VII. Ligjëratat-prezantimet, ligjërues/e i/e ftuar në universitet dhe punëtori shkencore nga lëmia e kandidatit/es

Nr	Autorët (renditja si në Ligjëratë/Prezantim)	Titulli i ligjëratës/prezantimit	Lloji i ligjëratës/prezantimit (Universiteti, Punëtori shkencore)	Viti, Vendi
1	/	/	/	/

Tabela VIII. Redaktor/e -Recensent/e në revistat akademike apo shkencore

Nr	Kontributi (redaktore-recensent/e)	Autori/ët e punimit	Titulli i punimit të recensuar	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recensioni	Vendi, Viti
1					

2	Anëtar i bordit redaktues	—	—	Justicia (Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës)	Tetovë, 2020
3	Anëtar i Këshillit Botues	—	—	Vizione	Shkup, 2013 - në vazhdim
4	Anëtar i Bordit të Redaksisë	—	—	EURAS (Revistë shkencore ndërkombëtare)	Stamboll, 2013

Tabela IX. Trajnimet profesionale

Nr	Trajnimi (Titulli i trajnimit)	Certifikata	Viti
1	"Pedagogjia e Mësimdhënies"	Certifikatë – Ohio Northern University (SHBA) dhe UIBM	2019
2	Tema: "Mësimdhënia Universitare"	Certifikata e Universitetit të Hong Kongut	2023
3	"Eksplorimi i Mësimdhënies dhe Vlerësimit në Arsimin e Lartë" Gjashtë (6) modulet e kursit janë: 1. Pikëpamjet mbi të nxënit. 2. Kontekstet e mësimdhënies. 3. Shembuj autentikë nga praktika. 4. Vlerësimi efektiv. 5. Njohuritë dhe kompetencat në fushën e vlerësimit. 6. Informatat kthyese që nxisin angazhimin.	Certifikata e Universitetit Coventry Mbretëria e Bashkuar	2023

Tabela X. Angazhimi në projekte

Nr	Lloji	Emri i projektit	Pozita në projekt	Kohëzgjatja
1	Ndërkombëtar	Doing Business – World Bank Group	Ekspert ligjor – konsulent	2010-2018
2	Ndërkombëtar	World Justice Project (WJP), Rule of Law Index	Ekspert ligjor - konsulent i jashtëm	2020 - në vazhdim

3	Vendor	Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit i sistemit prokurorial të Kosovës 2022-2024 (Këshilli Prokurorial i Kosovës)	Anëtar i grupit punues	Gjatë mandatit në KPK (2020-2023)
4	Vendor	Rishikimi i kornizës ligjore dhe hartimi i legjislacionit kadastral në Kosovë (Agjencioni Kadastral i Kosovës)	Anëtar i grupeve profesionale	2010
5	Ndërkombë tar	Grupet punuese për vlerësimin e paluajtshmërive (Projekti ALUP)	Anëtar	
6	Vendor	Hartimi i legjislacionit - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, etj), në Kuvendin e Kosovës.	Ekspert Ligjor - i angazhuar për nevokja të Komisioneve	2005

3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, angazhimet profesionale në hulumtimet shkencore dhe projektet e tjera në të cilat ka marrë pjesë kandidati, programi prej të cilit është financuar projekti, çmimet dhe mirënjohjet, kualifikimet e ndryshme, patentat, inovacioni etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Kandidati Agron Beka ka qenë në pozita udhëheqëse akademike dhe profesionale, si në vijim:

- 2017-2022 – Dekan i Fakultetit Juridik dhe kryesues i Këshillit të Fakultetit, UIBM;

- 2017-2022 - Senator i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë;

- 2020-2023 - Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga rradhët e Fakulteteve të Drejtësisë në Kosovë;

- 2011-2019 - Kryeredaktor dhe anëtar i redaksisë së revistës shkencore "Juridica", Kolegji Evropian Juridica, Prishtinë;

- 2012-2015 - Dekan, Kolegji Evropian Juridica, Prishtine;

- Anëtar i Grupit Punues të Këshillit Prokurorial të Kosovës për hartimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit të Sistemit Prokurorial të Kosovës 2022-2024;

- 2013 - në vazhdim - Anëtar i Këshillit Botues të revistës shkencore "Vizione" (Shkup) dhe i Bordit të Redaksisë së revistës ndërkombëtare EURAS.

- 2020 - Anëtar bordit redaktues të revistës "Justicia" (Tetovë);

- Dhjetor 2021 - Kryesues i Këshillit Organizativ të Konferencës Shkencore "Të drejtat e njeriut, kriminaliteti dhe ekonomia në kohë të pandemisë COVID-19" (UIBM) dhe i disa konferencave të tjera vendore dhe ndërkombëtare;

- 2005 - Ekspert Ligjor në Kuvendin e Kosovës - Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi; Komisioni për Administrim të Pushtetit Lokal.

- 2010-2018 - Ekspert ligjor - konsulent në "Doing Business" të Bankës Botërore;
- 2020 - Ekspert ligjor në Projektin Botëror të Drejtësisë (WJP Rule of Law Index) Washington;
- 2010 - Ekspert ligjor i projektit të Bankës Botërore;
- 2010 - Anëtar i grupeve profesionale për rishikimin e kornizës ligjore dhe hartimin e legjislacionit kadastral në Kosovë (Agjencioni Kadastral i Kosovës);
- 2008 - Anëtar i Komisionit për Provim të Noterisë, Ministria e Drejtësisë;
- 2005 - 2010 - Ekspert Ligjor-Profesional i Bankave: "Teb Bank", "Raiffeisen Bank"."Kasa Bank"
- 2013 - Anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të së Drejtës Penale AIDP/IAPL (Paris);
- 2020 - Anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve (New York),
- 2003 - Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës;
- 1994 - 2025 - Autor i gjashtë (6) librave me aforizma personale; etj.

Çmime dhe mirënjohje: Mirënjohje e veçantë nga Gjimnazi "Muharrem Bekteshi" në Vushtrri me rastin e 50-vjetorit të themelimit; Mirënjohje nga Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (UIBM-ja) me rastin e 5-vjetorit të universitetit për kontributin në konsolidimin e këtij institucioni akademik.

4. Mobiliteti i kandidatit/es

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati/ja, si dhe institucionet e tjera në të cilat ai/ajo ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore, qëndrime hulumtuese jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

- Kandidati Agron Beka në vitin 2013 ka përfunduar doktoraturën në Fakultetin Juridik "Justiniani I" në Universitetin e Shkupit "Kiril dhe Metodi", Maqedonia e Veriut, ku ka fituar titullin Doktor i Shkencave Juridike.
- Ka përfunduar magjistraturën (Mr.Sc., fusha penale) në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.
- Ka përfunduar studimet themelore (Jurist) në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ku ka qenë bursist i universitetit.

5. Vlerësimi i kandidatit/es në intervistë (në rastet e krijimit të marrëdhënies së punës për herë të parë)

(Në këtë pjesë të raportit, komisioni duhet të ofrojë të dhëna të sakta dhe të plota, sipas pikës 2 të nenit 167 të Statutit të UIBM dhe pikave 2,3,4 të nenit 11 Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024).

6. Përfundimi dhe propozimi (titulli i cili propozohet)

(Anëtarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim për titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre për çdo

kandidat/e. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërsa katër kapitujt paraprakë shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).

Këshilli i Fakultetit Juridik të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë ka formuar komisionin vlerësues me Vendim Nr. Prot.300, datë:29.09.2026, në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Besnik Murati-Kryetar; Prof. Dr. Arsim Bajrami-Anëtar; Prof. Dr. Rexhep Gashi-Anëtar, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për procedurën lidhur me avancim/rizgjedhje: për lëndët: "Taktika kriminalistike"; "Kriminologji me Penologji"; "Viktimologjia"; "Bazat e sistemit të drejtësisë"; "Terrorizmi dhe Antiterrorizmi"; "Politika e luftimit të kriminalitetit".

Komisioni vlerësues, pasi analizoi dokumentacionin e prezentuar nga kandidati i vetëm Prof. Asoc. Dr. Agron Beka, i cili ka konkuruar për rizgjedhje në thirrjen akademike Prof. Asoc. Dr. (Profesor i Asociuar), konstatoojm se kandidati është angazhuar në procesin e mësimdhënies universitare që nga viti 2007 në disa institucione të arsimit të lartë me seli në Prishtinë, dhe nga viti 2015 në Fakultetin Juridik të UIBM, ku aktualisht është Profesor i Asociuar. Kandidati ka botuar libra dhe materiale mësimore në lëndët e konkursit (Taktika Kriminalistike; Bazat e sistemit të drejtësisë; Vrasjet, Krimi i Organizuar, Terroizmi; Viktimologjia).

Komisioni vlerësues gjithashtu konstaton se Prof. Agron Beka ka përfunduar doktoraturën në vitin 2013 në Fakultetin Juridik "Justiniani I" të Universitetit të Shkupit "Kiril dhe Metodi" (fusha penale - kriminologji); Magjistraturën (fusha penale) dhe studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Prof. Agron Beka pas thirrjes së fundit ka publikuar tri (3) punime shkencore të indeksuara në SCOPUS, në të cilat është autor i parë, ka mbajtur shtatë (7) Konferenca Shkencore Vendore dhe Ndërkombëtare, po ashtu ka publikuar Monografi dhe Libra Shkencore, dhe sipas dokumentacionit të ofruar ka gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) punime shkencore në revista ndërkombëtare gjatë periudhës 2021-2026.

Prof. Beka ka shërbyer në funksione të ndryshme udhëheqëse si dekan, senator në UIBM; Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës (2020 -2023), si dhe është anëtar i redaksive të disa revistave shkencore dhe ka qenë ekspert ligjor në projekte të ndryshme ndërkombëtare (Banka Botërore, WJP).

Hartimi i raportit konform legjislacionit në fuqi

Komisioni vlerësues në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Besnik Murati-Kryetar; Prof. Dr. Arsim Bajrami-Anëtar; Prof. Dr. Rexhep Gashi-Anëtar, konstaton se aplikimi është bërë konform kërkesave të konkursit me Nr. Prot. 2193, datë: 23.09.2026, si dhe korigjimit të konkursit me Nr. Prot. 2249, datë: 29.09.2026, dhe janë plotësuar kushtet konform Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, si dhe Rregullores për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM, me Nr. Prot. 3013, datë: 21.12.2023, dhe Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për procesin e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM, me Nr. Prot. 1621, datë: 26.07.2024. Komisioni vlerësues erdhi në përfundim dhe propozon si në vijim:

PROPOZIM: Komisioni vlerësues, pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentacionit të paraqitur, vlerëson se kandidati Prof. Asoc. Dr. Agron Beka i plotëson të gjitha kushtet e parapara me

dispozitat ligjore në fuqi për t'u rizgjedhur në thirrjen akademike "Profesor i Asociuar" (Prof. Asoc. Dr.). Duke marrë parasysh atë që u theksua më lart, komisioni vlerësues i PROPOZON Këshillit të Fakultetit Juridik dhe Senatit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë që të rizgjedhë kandidatin Prof. Asoc. Dr. Agron Beka në thirrjen akademike PROFESOR I ASOCIUAR (Prof. Asoc. Dr.) për lëndët: Taktika kriminalistike; Kriminologji me Penologji; Viktimologjia; Bazat e sistemit të drejtësisë; Terrorizmi dhe Antiterrorizmi; Politika e luftimit të kriminalitetit.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:
[*të shënohet thirrja e saktë akademike*]

1. Prof. Asoc. Dr. Besnik Murati

2. Prof. Dr. Arsim Bajrami

3. Prof. Dr. Rexhep Gashi

Datë: 27.10.2026